



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2012  
Nr. ref.: VMP325/12

## VENDIM PËR VAZHDIM TË MASËS SË PËRKOHSHME

në

**Rastin Nr. KI78/12**

Parashtruesi

**Bajrush Xhemajli**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr.  
70/2012, të 22 qershorit 2012**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

## Hyrje

1. Më 24 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese lejoi masën e përkohshme përkitazi me kërkesën e sipërpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, vendosi:
  - I. TË LEJOJË, me gjashtë vota për dhe dy kundër, masën e përkohshme;
  - II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012, duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi; dhe,
  - III. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012; urdhërdënimin me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012, për të njëjtën periudhë kohore.

## Korrespondenca nga Gjykata Supreme

2. Më 21 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme ta dorëzonte dosjen e lëndës P. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.
3. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese edhe një herë kërkoi nga Gjykata Supreme që ta dorëzonte dosjen e lëndës P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; AP. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.
4. Më 20 nëntor 2012, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese, duke dorëzuar dosjen e lëndës P. Nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; AP. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.
5. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese merr parasysh nevojën për të shqyrtuar përgjigjen e Gjykatës Supreme, që tani është pranuar, duke përfshirë dosjen e lëndës P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; Ap. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. nr. 70/2012 dhe, gjithashtu, edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të çështjes më 5 dhjetor 2012,

